



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

R. nr. 489/2024

Respektimi i të drejtave për përdorimin e simboleve kombëtare

Drejtuar:

Z. Xhelal Sveçla, Ministër
Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Lulzim Hetemi, Kryetar
Komuna e Leposaviqit

Kopje :

Z. Elbert Krasniqi, Ministër
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Z. Habit Hajredini, Drejtor
Zyra për Qeverisje të Mirë - Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, më 7 prill 2025

Qëllimi i raportit

1. Ky raport me rekomandime ka për qëllim t'i paraqesë vlerësimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit, lidhur me ankesën individuale të z. Branko Marinković (në tekstin e mëtejshëm: ankuesi), parashtruar në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) në emër të organizatës joqeveritare “Asocijacija za Razvoj Leposavic”, përkitazi me pretendimet për cenimin e të drejtave të komunitetit serb si pasojë refuzimit të kërkesës nga Komuna e Leposaviqit për vendosjen e flamujve kombëtarë në hapësirat publike për kremtimin e festës “Sveti Vasilija”. Raporti mbështetet në faktet dhe në provat e ankuesit si dhe në shkresat e lëndës, të cilat i posedon Avokati i Popullit, përkitazi me çështjen e ngritur nga ankuesi.
2. Vlerësimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit në këtë raport janë paraqitur duke u bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me standardet ndërkombëtare dhe me ligjet e zbatueshme në vend.

Baza ligjore

3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: “Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.” Ndërsa në nenin 135, paragrafi 3, përcakton: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”
4. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - “Për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit (neni 16, paragrafi 1);
 - të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2);
 - t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6).

Përmbledhje e fakteve dhe veprimet e Avokatit të Popullit

5. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 20 maj 2024 pranoi ankesën e Branko Marinković, në emër të organizatës joqeveritare “Asocijacija za Razvoj Leposavic”, parashtruar kundër Komunës së Leposaviqit, për mosrespektimin e të drejtave të komunitetit serb për përdorimin e flamujve kombëtarë në vende publike, me rastin e festës “Sveti Vasilija”.
6. Sipas pohimeve të ankuesit dhe dokumentacionit që paraqiti, z. Marinković, më 10 maj 2024, duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-047 për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës, iu drejtua Komunës së Leposaviqit – Drejtorisë për Shërbime Publike, me kërkesë

që me rastin e festës “Sveti Vasilija”, të lejohet zëvendësimi dhe vendosja e flamujve kombëtarë të komunitetit serb në hapësirat publike.

7. Më 10 maj 2024, kryetari i Komunës së Leposaviqit nxori Vendimin nr. 987, nëpërmjet të cilit u theksua si vijon: *“Në bazë të kërkesës së bërë nga Branko Matinković për festën “Sveti Vasilija” për vendosjen e flamujve Serb në hapësirat publike, Kryetari i Komunës së Leposaviqit merr vendim për të mos lejuar që këta flamuj të vendosen nëpër këto hapësira publike.”* Përkitazi me këtë vendim, ankuesi u ankua për mungesën e bazës ligjore në vendim dhe për mosrespektim të të drejtave të komunitetit serb për përdorimin e simboleve kombëtare.
8. Më 6 qershor 2024, Avokati i Popullit nëpërmjet një shkrese kërkoi nga kryetari i Komunës së Leposaviqit informata përkitazi me arsyen e mungesës së elementeve të detyrueshme të aktit administrativ¹ në vendim, respektivisht bazën ligjore për nxjerrjen e vendimit, arsyetimin dhe mjetet juridike.
9. Meqenëse nuk mori përgjigje, Avokati i Popullit më 31 korrik 2024 i dërgoi shkresë rikujtuese kryetarit të Komunës së Leposaviqit, mirëpo as në këtë shkresë nuk mori përgjigje.

Baza ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre]

“Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet:

[...]

(7) të përdorin dhe të shfaqin simbolet e komunitetit, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.”

Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

Neni 11

[...]

“2. Palët angazhohen të njohin se çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të shfaqë në gjuhën e tij/saj të pakicës shenja, mbishkrime dhe informacione të tjera të një natyre personale në mënyrë të dukshme për publikun.”

Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës

Neni 5 [Kultura]

[...]

“5.5 Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të festojnë festat e tyre tradicionale dhe fetare në mënyrë të lirë dhe të hapur në pajtim me ligjin

5.6 Komunitetet dhe organizatat e tyre përfaqësuese kanë të drejtën të përdorin dhe shfaqin simbolet e komunitetit të tyre në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.”

[...]

¹ Ligji nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Neni 47.

Ligji nr. 03/L-038 për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës

Neni 6 [Përdorimi i flamujve kombëtarë]

“6.1 Çdo qytetar i Republikës së Kosovës ka të drejtë të përdorë flamujt kombëtarë në pajtim me këtë ligj dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

6.2 Qytetarët e të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës kanë të drejtën, në mënyrë individuale apo si komunitet, të përdorin flamujt kombëtarë në pajtim me këtë ligj dhe me standardet ndërkombëtare.

6.3 Për mënyrën e përdorimit të flamujve kombëtarë në mjedise të brendshme dhe të jashtme në institucionet publike, Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr akte përkatëse nënligjore.

6.4 Ndalohet vendosja publike e flamujve kombëtarë nëse janë të vjetruar apo të dëmtuar.”

Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Neni 47 [Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar]

“1. Akti administrativ i shkruar përmban:

1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes;

1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit.

1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin);

1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.”

Analiza ligjore

10. Ankuesi, në emër të organizatës joqeveritare “Asocijacija za Razvoj Leposavic”, u ankua për mosrespektimin e të drejtave të komunitetit serb nga Komuna e Leposaviqit për përdorimin e simboleve kombëtare në hapësirat publike dhe për mungesën e bazës ligjore në vendimin e nxjerrë nga Komuna e Leposaviçit, me të cilin u refuzua kërkesa e ankuesit.

11. Në rendin juridik të Republikës së Kosovës, përdorimi dhe shfaqja e simboleve të pjesëtarëve të komuniteteve është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, me Ligjin Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës dhe me Ligjin nr. 03/L-038 për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës.

12. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre], në paragrafi 7, garanton: *“Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet: (7) të përdorin dhe të shfaqin simbolet e komunitetit, në pajtim me ligjin dhe standardet.”* Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, në nenin 11, paragrafi 2, shprehimisht përcakton: *“Palët angazhohen*

të njohin se çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të shfaqë në gjuhën e tij/saj të pakicës shenja, mbishkrime dhe informacione të tjera të një natyre personale në mënyrë të dukshme për publikun.”

13. Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, në nenin 5, paragrafi 5.5, shprehimisht përcakton: *“Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të festojnë festat e tyre tradicionale dhe fetare në mënyrë të lirë dhe të hapur në pajtim me ligjin.”* Ndërsa në paragrafin 5.6 përcakton: *“Komunitetet dhe organizatat e tyre përfaqësuese kanë të drejtën të përdorin dhe shfaqin simbolet e komunitetit të tyre në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.”*
14. Ndërsa Ligji nr. 03/L-038 për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës, në nenin 6, i cili rregullon përdorimin e flamujve kombëtarë, shprehimisht përcakton si vijon: *“6.1 Çdo qytetar i Republikës së Kosovës ka të drejtë të përdorë flamujt kombëtarë në pajtim me këtë ligj dhe me legjislacionin tjetër në fuqi. 6.2 Qytetarët e të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës kanë të drejtën, në mënyrë individuale apo si komunitet, të përdorin flamujt kombëtarë në pajtim me këtë ligj dhe me standardet ndërkombëtare. 6.3 Për mënyrën e përdorimit të flamujve kombëtarë në mjedise të brendshme dhe të jashtme në institucionet publike, Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr akte përkatëse nënligjore. 6.4 Ndalohet vendosja publike e flamujve kombëtarë nëse janë të vjetruar apo të dëmtuar.”*
15. Duhet theksuar se rendi juridik i Republikës së Kosovës ka qasje të avancuar për sa i përket mbështetjes së të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre për t'i përdorur dhe shfaqur simbolet kombëtare të komunitetit, si dhe për t'i përdorur individualisht apo si komunitet flamujt kombëtarë. Kushtetuta dhe ligjet përkatëse ofrojnë mbrojtje të fortë ligjore për këto të drejta, duke siguruar që përdorimi i simboleve kombëtare të jetë në përputhje me normat ligjore dhe standardet ndërkombëtare, të cilat janë esenciale për ruajtjen e identiteteve kulturore dhe respektimit të diversitetit të qytetarëve të Kosovës.
16. Megjithatë, përveç garancive kushtetuese dhe ligjore për garantimin e kësaj të drejte, Avokati i Popullit ka gjetur se mënyra e përdorimit të flamujve kombëtar në mjedise të brendshme dhe të jashtme në institucionet publike ende nuk është e rregulluar me akte përkatëse nënligjore. Ligji nr. 03/L-038 për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës, në lidhje me mënyrën e përdorimit të flamujve kombëtarë, në nenin 6, paragrafi 6.3 specifikon si vijon: *“Për mënyrën e përdorimit të flamujve kombëtarë në mjedise të brendshme dhe të jashtme në institucionet publike, Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr akte përkatëse nënligjore.”* Përkitazi me këtë dispozitë ligjore, e cila kërkon që mënyra e përdorimit të flamujve kombëtarë të rregullohet me akte nënligjore, Avokati i Popullit ka vërejtur se akti nënligjor përkatës ende nuk është nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, apo respektivisht nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila është sponsorizuese e ligjit përkatës. Rrjedhimisht, mosnxjerrja e një akti nënligjor për mënyrën e përdorimit të flamujve kombëtarë në hapësirat publike dhe institucionale përbën zbrastim ligjore në këtë aspekt dhe krijon paqartësi për mënyrën e veprimeve procedurale për zbatimin e së drejtës përkatëse.
17. Por, në përjashtim të kësaj, garancitë ligjore në Republikën e Kosovës qartë lejojnë të drejtën e të gjithë qytetarëve të të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës që në mënyrë individuale apo si komunitet, t'i përdorin flamujt kombëtarë në pajtim me ligjin dhe me standardet ndërkombëtare. Këtë të drejtë e gëzojnë të gjithë pjesëtarët e

komuniteteve në vend, e cila ua lejon t'i përdorin simbolet e tyre kombëtare për kremtimin e çdo feste, përfshirë si në rastin konkret festën fetare “Sveti Vasilija”, nëse praktikë e kësaj feste është festimi me flamuj kombëtarë nga komuniteti përkatës.

18. Përkitazi me pretendimet e ankuesit se Komuna e Leposaviqit nuk i ka respektuar të drejtat të komunitetit serb për përdorimin e simboleve kombëtare në hapësira publike, gjatë shqyrtimit të lëndës, Avokati i Popullit ka vërejtur se organizata joqeveritare “Asocijacija za Razvoj Leposavic”, në kërkesën drejtuar Komunës më 10 maj 2024, ka kërkuar nga kjo e fundit që me rastin e festës “Sveti Vasilija”, të lejohet zëvendësimi dhe vendosja e flamujve kombëtarë të komunitetit serb në hapësirat publike. Megjithatë kërkesa drejtuar Komunës është vërejtur se nuk ishte e specifikuar në mënyrë të qartë se në cilat hapësira publike është kërkuar vendosja e flamujve dhe nuk është qartësuar se realisht çfarë është nënkuptuar me “zëvendësimin” e flamujve.
19. Çështja e kërkesës për zëvendësimin e flamujve, në mungesën e qartësimit nga pala kërkuuese, u konsiston kuptimeve të ndryshme, andaj është shumë e rëndësishme të specifikohet nënkuptimi i përdorimit të termit “zëvendësim” në kuptimin se flamujt kombëtarë të komunitetit serb cilët flamuj do t'i zëvendësonin, në mënyrë që kërkesa të marrë një epilog duke u bazuar në rregullat ligjore të Republikës së Kosovës.
20. Në lidhje me pretendimet e ankuesit se vendimi i nxjerrë nga Komuna e Leposaviqit, si përgjigje ndaj kërkesës së tyre, nuk ka bazë ligjore, Avokati i Popullit ka analizuar vendimin përkatës në raport me legjislacionin në fuqi.
21. Gjatë shqyrtimit të lëndës, Avokati i Popullit ka vërejtur se Vendimi nr.987, i datës 10 maj 2024, i nxjerrë nga kryetari i Komunës së Leposaviqit, për t'iu përgjigjur kërkesës së ankuesit, nuk është nxjerrë në përputhje me Ligjin nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Ky ligj me nenin 47 rregullon strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar. Në paragrafin 1 të nenit 47, ligji shprehimisht përcakton si vijon:
“1. Akti administrativ i shkruar përmban:
1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes;
1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit.
1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin);
1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.”
22. Qëllimi kryesor i kësaj dispozite është ta integrojë parimin e qartësisë dhe sigurisë juridike në praktikën e procedurës administrative, një parim kushtetues që rrjedh nga sundimi i

ligjit. Sundimi i ligjit, nga i cili buron parimi i qartësisë dhe i sigurisë juridike, është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Qartësia dhe siguria e një akti administrativ do të thotë që personit, të cilit i drejtohet akti administrativ, mund të kuptojë plotësisht dhe qartë përmbajtjen e tij rregulluese, e cila përcaktohet kryesisht nga dispozitivi i tij, në mënyrë që të veprohet sipas dispozitës. Parimi i qartësisë dhe i sigurisë është i rëndësishëm jo vetëm për të mbrojtur interesin publik, por edhe interesin individual të personave, të cilëve u drejtohet akti administrativ, qëllimi i të gjithë elementëve është gjithashtu të sigurojnë që personi, të cilit i drejtohet akti administrativ, të jetë në gjendje të kuptojë përmbajtjen e vendimit administrativ dhe arsyet e tij faktike dhe juridike.²

23. Nisur nga garancitë ligjore të specifikuara më lart, Avokati i Popullit ka vërejtur se Vendimi nr. 987, i datës 10 maj 2024, i nxjerrë nga kryetari i Komunës së Leposaviqit nuk i përmban të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ. Konkretisht, përveç dispozitivit, vendimi nuk i përmban elementet e tjera, si: pjesën hyrëse (vetëm pjesërisht), arsyetimin dhe pjesën përmbyllëse të tij, përfshirë edhe udhëzimin për mjetet juridike.
24. Një akt administrativ me mungesë të përmbajtjes së elementeve të detyrueshme, përveçqë nuk është akt i nxjerrë në pajtim me ligjin dhe krijon pasiguri juridike te secili individ apo grup individësh në procedurë, po ashtu krijon paqartësi për kuptimin dhe përmbajtjen e rregullimit juridik, përkatësisht për shkaqet kryesore faktike dhe ligjore të cilat organi publik i ka marrë parasysh gjatë marrjes së vendimit dhe po ashtu krijon paqartësi edhe për të drejtën e palës për mbrojtje juridike. Informimi për mjetet juridike në dispozicion është i rëndësishëm për ndërgjegjësimin korrekt të palëve në procedurë dhe për respektimin kushtetues dhe ligjor të së drejtës themelore për mjetet juridike.³
25. Rrjedhimisht, bazuar në paragrafin 1 të nenit 47 të Ligjit nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme, i cili rendit një listë të elementeve të detyrueshme që duhet të përmbajë çdo akt administrativ i shkruar në mënyrë që të jetë plotësisht në pajtim me ligjin, Avokati i Popullit vlerëson se vendimi konkret nuk është nxjerrë në pajtim me ligjin, në kuptimin e aspektit përmbajtjesor dhe strukturor.

Obligimi ligjor për bashkëpunim me Avokatin e Popullit

26. Duke marrë parasysh faktin se Avokati i Popullit nuk ka marrë përgjigje në dy shkresat drejtuar kryetarit të Komunës së Leposaviqit, përkitazi me këtë rast, Avokati i Popullit rikujton se bazuar në detyrimin kushtetues, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 132, në paragrafi 3, përcakton: *“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*
27. Obligimi për bashkëpunim me Avokatin e Popullit përcaktohet edhe me Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i cili në nenin 18, paragrafi 6, shprehimisht përcakton:

² Komentari Ligjor i Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative të Republikës së Kosovës, 2022 (Përmbajtja dhe qëllimi i Nenit 47).

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”*

Ligji nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Neni 13 - Parimi i së drejtës në mjete juridike: *“Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik.”*

“Avokati i Popullit [...], mund të kërkojë nga çdo autoritetet i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, përfshirë edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve sipas kërkesës së Avokatit të Popullit.” Ndërsa me nenin 25, paragrafi 1, ligji përcakton: *“Të gjitha autoritetet kanë për obligim t’i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t’i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij.”* Rrjedhimisht, në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 25, ligji i përcakton pasojat e refuzimit të bashkëpunimit me Avokatin e Popullit.

28. Avokati i Popullit rikujton se refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit është mosrespektim i Kushtetutës dhe i ligjit dhe njëkohësisht paraqet pengesë në zhvillimin e hetimeve të Avokatit të Popullit për rastet të cilat i ka në trajtim.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

29. Avokati i Popullit, duke u bazuar në të drejtat e garantuara dhe në të gjeturat e paraqitura në këtë raport, konstaton se rendi juridik i Republikës së Kosovës është i qartë dhe i strukturuar në mbështetje të të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre për t’i përdorur dhe shfaqur simbolet e komuniteteve të tyre, si dhe për të përdorur individualisht apo si komunitet flamujt kombëtarë. Garancitë ligjore në Republikën e Kosovës qartësisht ua lejojnë të drejtën e të gjithë qytetarëve të të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës që në mënyrë individuale apo si komunitet t’i përdorin flamujt kombëtarë, në pajtim me ligjin dhe me standardet ndërkombëtare.
30. Avokati i Popullit konstaton se mungesa e rregullimit me akte nënligjore për mënyrën e përdorimit të flamujve kombëtarë në mjedise të brendshme dhe të jashtme të institucioneve publike, siç është parashikuar me Ligjin nr. 03/L-038 për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës (neni 6, paragrafi 6.3), është mangësi ligjore e cila përveçse krijon pengesa administrative dhe vendimmarrëse për zbatimin e ligjit përkatës, krijon edhe pasoja për standardizimin dhe unifikimin e përdorimit të flamujve në mjedise publike. Në mungesë të akteve nënligjore, mund të ketë dallime në interpretimin e ligjit, të cilat e vështirësojnë procesin e mbikëqyrjes dhe kontrollit nga autoritetet kompetente. Gjithashtu, në rastet kur institucionet publike hasin në kërkesa të tilla, mund të krijohet një pasiguri ligjore dhe administrative për të vendosur në procedurë administrative. Një qasje e tillë përbën qasje diskriminuese dhe si e tillë duhet synuar që të evitohet.
31. Avokati i Popullit konstaton se Komuna e Leposaviqit, me Vendimin nr. 987 të nxjerrë më 10 maj 2024, drejtuar ankuesit, nuk ka vepruar në pajtim me Ligjin nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për sa i përket strukturës së vendimit dhe elementeve të detyrueshme të aktit administrative të shkruar, që rrjedhin nga neni 49 i këtij ligji. Avokati i Popullit rikujton përmbajtjen e parimit të ligjshmërisë, i cili qartazi specifikon si vijon: *“1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. [...]”*⁴
32. Andaj, duke u bazuar në rrethanat e cekura më lart, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga*

⁴ Ligjin nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 4 Parimi i ligjshmërisë, paragrafi 1.

ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke u referuar në argumentet e lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin administrativ të Kosovës,

REKOMANDON

Ministritë së Punëve të Brendshme:

- Në pajtim me kompetencat kushtetuese dhe ashtu siç parashihet me Ligjin nr. 03/L-038 për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës, t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për nxjerrjen e akteve nënligjore për mënyrën e përdorimit të simboleve kombëtare në hapësirat publike.

Komunës së Leposaviqit:

- T'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për të vendosur në kërkesën e ankuesit nëpërmjet një vendimi i cili duhet të jetë në përputhje me nenin 47 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit